LIGJ
Nr. 29/2025

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIMIN MBI SIGURINË DHE MBËSHTETJEN AFATGJATË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE UKRAINËS

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja për bashkëpunimin mbi sigurinë dhe mbështetjen afatgjatë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ukrainës sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.6.2025.

Shpallur me dekretin nr. 188, datë 20.6.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

Marrëveshje për bashkëpunimin mbi sigurinë dhe mbështetjen afatgjatë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ukrainës

Parathënie

Republika e Shqipërisë dhe Ukraina (më poshtë referuar si "Pjesëmarrësit", ose "Shqipëria" dhe "Ukraina") ritheksojnë dënimin e tyre në termat më të fortë të mundshëm të luftës pashkak, të pajustifikuar dhe të paligjshme të Rusisë kundër Ukrainës, e cila përbën një shkelje të dukshme të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë Kartën e OKB-së, Aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit.

Shqipëria rikonfirmon mbështetjen e saj të palëkundur për pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht që nga viti 1991, duke përfshirë ujërat territoriale, dhe njeh të drejtën themelore të Ukrainës për vetëmbrojtje, siç parashikohet në nenin 51 të Kartës së OKB-së.

Pjesëmarrësit pranojnë se Ukraina dhe e gjithë Europa nuk do të jenë të sigurtë derisa të ketë një paqe të plotë dhe të qëndrueshme që respekton të drejtat e Ukrainës sipas ligjit ndërkombëtar dhe Kartës së OKB-së.

Bashkëpunimi ndërmjet pjesëmarrësve mbështetet nga një sërë vlerash të përbashkëta, si demokracia, sundimi i ligjit, respektimi dhe ruajtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe barazia gjinore.

Pjesëmarrësit sjellin në vëmëndje se Ukraina do të vazhdojë të zbatojë një program ambicioz reformash dhe se Shqipëria është e përkushtuar për të mbështetur përpjekjet e Ukrainës për reforma. Këto janë thelbësore për aspiratat e saj Europiane dhe Euroatlantike.

Pjesëmarrësit ripohojnë se anëtarësimi i Ukrainës në Bashkimin Europian dhe në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut janë në interesin strategjik të Shqipërisë dhe Ukrainës.

Shqipëria e ka mbështetur Deklaratën e Përbashkët të Mbështetjes për Ukrainën të datës 12 korrik 2023 (në vijim referuar si "Deklarata e G7"), e miratuar nga Grupi i Shtatshes (G7) dhe BE-ja në prag të Samitit të NATO-s në Vilnius dhe Marrëveshja e Ukrainës e nisur dhe miratuar më 11 korrik 2024 në prag të Samitit të NATO-s në Uashington, D.C.

Pjesëmarrësit nënvizojnë se kjo Marrëveshje nuk është një delegim për anëtarësimin e ardhshëm të Ukrainës në NATO.

Prandaj, Pjesëmarrësit kanë rënë dakord bashkërisht që të forcojnë bashkëpunimin e tyre të sigurisë duke ndjekur angazhimet dhe aktivitetet e mëposhtme dypalëshe afatgjata të sigurisë.

Pjesa I. Siguria dhe mbrojtja

1. Shqipëria do të shohë çdo mundësi dhe do të ofrojë mbështetje të mëtejshme lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen për Ukrainën në të gjitha fushat, me fokus në nevojat më urgjente të Ukrainës duke nxitur një bashkëveprim më të madh me partnerët Euroatlantikë. Shqipëria mbështet idenë e Forcave të Ardhshme të Ukrainës dhe do të vazhdojë të marrë pjesë, në mënyrë dypalëshe, shumëpalëshe dhe me partnerë (p.sh. brenda Bashkimit Europian, NATO-s dhe Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes së Ukrainës) në përpjekjet ndërkombëtare për të mbështetur modernizimin e Forcave të Mbrojtjes të Ukrainës për të siguruar një bashkërendim më të madh të tyre me NATO-n.

2. Shqipëria ndjek politikën e saj që të ndihmojë Ukrainën, si në baza dypalëshe ashtu dhe nëpërmjet bashkëpunimit me aleatët dhe partnerët, në ruajtjen e avantazheve cilësore të mbrojtjes ushtarake, mes transformimeve të shpejta, të pasigurta dhe sfiduese politike dhe të sigurisë rajonale.

3. Shqipëria do të punojë për mbështetjen e saj të trajnimit për Ukrainën në kuadrin shumëpalësh dhe mbështetjen dypalëshe në çdo formë tjetër trajnimi që mund të bihet dakord, duke përfshirë programet e stërvitjes së instruktorëve.

4. Shqipëria rikonfirmon mbështetjen e saj të vazhdueshme për Ukrainën nëpërmjet Paketës Gjithëpërfshirëse të Ndihmës (CAP) të NATO-s.

5. Shqipëria do të mbetet e angazhuar në përpjekjet shumëkombëshe për të mbështetur, përmirësuar dhe forcuar aftësitë mbrojtëse të Ukrainës, si dhe për të siguruar një bashkëveprim më të madh me NATO-n dhe partnerët e saj.

6. Duke pasur parasysh rëndësinë e bashkëpunimit civilo-ushtarak, Shqipëria do të shohë çdo mundësi materiale për të zbatuar projekte civilo-ushtarake me aftësi civile në mbështetje të Ukrainës, duke vënë theksin në ndihmën për popullsinë civile.

7. Që nga fillimi i pushtimit rus në shkallë të gjerë, Shqipëria ka mbështetur në mënyrë të gjithanshme Ukrainën me kontributet e saj në fusha të ndryshme, duke përfshirë ndihmën ushtarake dhe humanitare.

8. Shqipëria ka dhënë kontribute të rëndësishme ushtarake në Ukrainë, si në planin dypalësh ashtu edhe nëpërmjet forumeve shumëpalëshe, dhe do të vazhdojë të mbështesë më tej Ukrainën në të njëjtën mënyrë si në 2022-2024, duke u nisur nga nevojat më urgjente dhe të menjëhershme të Ukrainës për të forcuar aftësitë e saj të sigurisë dhe duke marrë parasysh mundësitë e Shqipërisë.

9. Shqipëria do të vazhdojë mbështetjen e saj për Ukrainën për periudhën dhjetëvjeçare sipas kësaj Marrëveshjeje.

10. Pjesëmarrësit do të zhvillojnë Dialogje për Politikat Strategjike të Mbrojtjes dhe Sigurisë në nivel të lartë.

11. Pjesëmarrësit do të punojnë së bashku për të forcuar aftësitë ushtarake të Ukrainës, me synimin për të arritur një nivel që, në rast të agresionit të jashtëm kundër Shqipërisë gjatë periudhës para anëtarësimit të Ukrainës në NATO, t'i mundësojë Ukrainës të reagojë me ndihmë efektive ushtarake.

12. Shqipëria do të japë kontributin e saj në koalicionin e avionëve luftarakë duke ofruar trajnime në gjuhën angleze për pilotët dhe teknikët ukrainas.

Bashkëpunimi në Industrinë e Mbrojtjes

13. Shqipëria mirëpret përpjekjet e Ukrainës për ta integruar industrinë e saj të mbrojtjes me përpjekjet e NATO-s dhe BE-së për të nxitur dhe rritur kapacitetet e prodhimit për mbrojtjes.

14. Shqipëria dhe Ukraina do të bashkëpunojnë për integrimin e industrive të tyre të mbrojtjes në bazën teknologjike dhe industriale të mbrojtjes Europiane (EDTIB), duke pasur parasysh edhe mundësitë e ofruara nga Strategjia Europiane e Mbrojtjes Industriale (EDIS) dhe Programi Europian i Industrisë së Mbrojtjes (EDIP).

15. Pjesëmarrësit do të kërkojnë mundësi dhe hapësira të tjera ekzistuese për industrinë e mbrojtjes dhe studimin e saj, duke zhvilluar përpjekjet për zbatimin e projekteve me interes të përbashkët.

16. Pjesëmarrësit do të identifikojnë mundësi për partneritete dhe bashkëpunime më të ngushta industriale të mbrojtjes, prodhim të përbashkët në fushën e mbrojtjes, duke përfshirë edhe Ukrainën, me qëllim përfitimin reciprok tregtar dhe politik.

17. Shqipëria do të bashkëpunojë me Ukrainën për të evidentuar burimet e mundshme të financimit për mbështetjen e projekteve të industrisë së mbrojtjes të Ukrainës.

18. Shqipëria do të punojë me Ukrainën për të forcuar mbrojtjen e proceseve të transferuara teknologjike dhe të të drejtave të aftësive krijuese.

Bashkëpunimi në fushën e Inteligjencës dhe Sigurisë

19. Pjesëmarrësit do të vazhdojnë të thellojnë bashkëpunimin e tyre në fushën e inteligjencës dhe sigurisë në përputhje me kornizën e bazuar në mekanizmat dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Siguria dhe mbrojtja kimike, biologjike, radiologjike, bërthamore (CBRN)

20. Duke njohur rreziqet për sigurinë dhe mbrojtjen CBRN, veçanërisht në situatat e konfliktit të armatosur, Shqipëria dhe Ukraina angazhohen të mbështesin dhe forcojnë kuadrin ekzistues global të sigurisë bërthamore bazuar në parimet, modelet, konventat, normat dhe standardet e IAEA-së, si dhe normat dhe instrumentet e tjera përkatëse juridike ndërkombëtare.

21. Shqipëria do të mbështesë përpjekjet e Ukrainës drejt sigurisë CBRN, qëndrueshmërisë dhe përmirësimit të saj, veçanërisht nëpërmjet shkëmbimit të praktikave të mira në forcimin e sigurisë së burimeve radioaktive të hermetizuara me aktivitet të lartë (INFCIRC/910) dhe kundër kontrabandës bërthamore (INFCIRC/918), dhe duke parë mundësi të tjera për sfidat që lidhen me incidentet CBRN.

Siguria Detare

22. Pjesëmarrësit do të kërkojnë të bashkërendojnë përpjekjet e tyre për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e sigurisë detare në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Detare, instrumentet e tjera ligjore ndërkombëtare dhe aktet e tyre kombëtare të sigurisë detare.

23. Shqipëria do të vazhdojë mbështetjen e saj për Ukrainën duke synuar ndërtimin e një kapaciteti modern dhe të fortë të sigurisë detare, duke përfshirë rritjen e bashkëveprimit dhe standardizimit me NATO-n.

Siguria kibernetike

24. Shqipëria dhe Ukraina do të synojnë të parandalojnë, zbulojnë, frenojnë dhe pengojnë çdo agresion kibernetik, spiunazh kibernetik dhe luftë hibride. Pjesëmarrësit do të synojnë gjithashtu që të njohin dhe të pengojnë

keqpërdorimin me dashje të aftësive kibernetike nga çdo aktor shtetëror dhe joshtetëror kundër Pjesëmarrësve.

25. Pjesëmarrësit do të mbështesin njëri-tjetrin duke shkëmbyer ekspertizën dhe duke u angazhuar në bashkëpunim praktik në fushat e sigurisë kibernetike dhe teknologjive të tjera të avancuara të komunikimit dhe informacionit (duke përfshirë, por pa u kufizuar në ndërtimin e kapaciteteve, zhvillimin e normave, kornizat ligjore, reagimin ndaj incidenteve dhe menaxhimin e krizave, qëndrueshmërinë domethënëse të infrastrukturës, ndërtimin e kapaciteteve në teknologjitë në zhvillim, etj.).

26. Shqipëria dhe Ukraina do të vazhdojnë shkëmbimin e informacionit, përvojës dhe bashkëpunimit në zhvillimin e sigurisë kibernetike dhe aftësive të mbrojtjes kibernetike, duke përfshirë rritjen e bashkëpunimit në diplomacinë kibernetike, ofrimin e asistencës teknike për Ukrainën, si dhe rritjen e fleksibilitetit të saj kibernetik.

Lufta kundër manipulimit dhe ndërhyrjes së informacionit të huaj

27. Pjesëmarrësit do të bashkëpunojnë në fushën e luftës kundër manipulimit dhe ndërhyrjes së informacionit të huaj, duke përfshirë manipulimin e informacionit nga Rusia apo ndonjështet tjetër, propagandën keqdashëse dhe fushatat dezinformuese që prekin sigurinë kombëtare.

28. Pjesëmarrësit do të shkëmbejnë rregullisht përvojën dhe praktikat më të mira në luftën kundër dezinformimit, komunikimit strategjik dhe diplomacisë publike.

Bashkëpunimi në luftën kundër krimit

29. Pjesëmarrësit do të vazhdojnë bashkëpunimin e tyre në kuadër të Traktatit të Miqësisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ukrainës, nënshkruar në Tiranë më 28 shkurt 2024.

30. Pjesëmarrësit pranojnë se krimi i rëndë dhe i organizuar (SOC) përbën një kërcënim për shoqëritë e tyre.

31. Për të luftuar të gjitha llojet e aktiviteteve të SOC, terrorizmit dhe krimeve të tjera, autoritetet kompetente të Pjesëmarrësve, në përputhje me legjislacionin kombëtar të Pjesëmarrësve, do të bashkëpunojnë në luftën dhe parandalimin efektiv të SOC dhe krimeve të tjera. Për këtë qëllim, Pjesëmarrësit do të marrin

masa për kryerjen e operacioneve të përbashkëta, shkëmbimin e informacionit mbi aktivitetet kriminale dhe njohjen e rreziqeve kryesore, krijimin e grupeve të përbashkëta të punës për bashkëpunimin policor dhe lehtësimin e ofrimit të trajnimit dhe shkëmbimit të praktikave më të mira. Masat e mësipërme nuk synojnë të jenë shteruese dhe Pjesëmarrësit mund të ndjekin forma të tjera bashkëpunimi për të arritur qëllimet e tyre në luftën kundër SOC.

Bashkëpunimi në luftën kundër trafikimit të drogës dhe trafikimit të qenieve njerëzore

32. Pjesëmarrësit do të bashkëpunojnë në luftën kundër trafikut të drogës dhe trafikimit të qenieve njerëzore, për të përmirësuar shkëmbimin e informacionit mbi rrjetet kriminale ndërkombëtare, metodat e tyre operacionale, likuiditetet financiare për të identifikuar dhe ndërprerë rrugët e trafikimit.

Pjesa II. Bashkëpunimi politik dhe promovimi i llogaridhënies

Vetëm Paqe

33. Shqipëria do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e Ukrainës për të vendosur një paqe të plotë dhe të qëndrueshme bazuar në parimet dhe objektivat kyçe të përcaktuara në Formulën e Paqes së Ukrainës. Shqipëria do të vazhdojë përpjekjet e saj diplomatike për të siguruar mbështetje të gjerë globale për zbatimin e saj, duke përfshirë vendet e Hemisferës Jugore për të zbatuar Formulën e Paqes së Ukrainës dhe për të marrë pjesë në Samitet përkatëse të Paqes dhe grupet e punës.

Llogaridhënia

34. Pjesëmarrësit do të kontribuojnë në ruajtjen e rendit juridik ndërkombëtar bazuar në parimet e Kartës së OKB-së në lidhje me sigurimin e llogaridhënies së Federatës Ruse dhe shteteve të tjera që kryejnë shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare.

35. Pjesëmarrësit riafirmojnë angazhimin e tyre për të garantuar përgjegjësitë për krimet ndërkombëtare të kryera në ose kundër Ukrainës, duke përfshirë krimin e agresionit. Pjesëmarrësit do të kërkojnë të sjellin para drejtësisë ata që janë përgjegjës për krimet e luftës dhe krimet e tjera ndërkombëtare të kryera në ose kundër Ukrainës në kontekstin e agresionit rus, në përputhje me ligjin ndërkombëtar, duke përfshirë mbështetjen e punës së Zyrës së Prokurorit të

Përgjithshëm të Ukrainës dhe Gjykatës Ndërkombëtare Penale për të siguruar që pretendimet për krime lufte dhe krime të tjera ndërkombëtare, përfshirë dhunën seksuale në konflikt, të hetohen plotësisht dhe në mënyrë të drejtë nga mekanizma të pavarur, efektiv dhe të fuqishëm ligjor.

36. Pjesëmarrësit do të punojnë së bashku si "Grup Bërthamë mbi mundësitë për krijimin e një gjykate për krimin e agresionit ndaj Ukrainës", për të krijuar një gjykatë për të siguruar përgjegjësinë për krimin e agresionit ndaj Ukrainës.

37. Si anëtarë të Koalicionit Ndërkombëtar për Kthimin e Fëmijëve Ukrainas, Pjesëmarrësit angazhohen të forcojnë përpjekjet e tyre për kthimin e sigurt të të gjithë fëmijëve ukrainas të dëbuar ilegalisht dhe të zhvendosur me forcë dhe ribashkimin me familjet e tyre, si dhe të mbështesin përpjekjet ndërkombëtare që synojnë sigurimin e llogaridhënies së atyre që janë përgjegjës.

Kompensimi për dëmin, humbjen dhe lëndimin e shkaktuar nga agresioni rus

38. Pjesëmarrësit riafirmojnë angazhimin e tyre për ta mbajtur Federatën Ruse përgjegjëse për shkaktimin e dëmeve, humbjeve dhe lëndimeve të individëve dhe subjekteve, si dhe ndaj shtetit të Ukrainës, si rezultat i veprimeve të saj të paligjshme ndërkombëtare në një mënyrë ose në një tjetër kundër Ukrainës, duke përfshirë agresionin e saj në shkelje të Kartës së OKB-së dhe se Federata Ruse mban përgjegjësi financiare për rindërtimin afatgjatë të Ukrainës.

39. Asetet ruse me vlerë duhet të mbahen të ngrira derisa Federata Ruse të ketë paguar për dëmin që i ka shkaktuar Ukrainës. Shqipëria, duke punuar me partnerët e saj në Bashkimin Evropian, do të vazhdojë të eksplorojë rrugë të ligjshme në përputhje me detyrimet kontraktuale të zbatueshme dhe në përputhje me ligjin e BE-së dhe atë ndërkombëtar, nëpërmjet të cilave asetet ruse të mund të përdoren për të mirën e Ukrainës.

40. Si prioritet, Pjesëmarrësit do të vazhdojnë të punojnë së bashku me partnerët e tjerë në drejtim të krijimit të një mekanizmi ndërkombëtar kompensimi për të siguruar kompensim për dëmin, humbjen ose lëndimin e shkaktuar nga agresioni rus, siç parashikohet nga Statuti i Regjistrit të Dëmeve të shkaktuara nga Agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës miratuar me Rezolutën e Këshillit të Ministrave të Europës CM/Res(2023)3. Në këtë drejtim, Pjesëmarrësit do të shqyrtojnë alternativat e duhura për financimin e një mekanizmi ndërkombëtar kompensimi për të ofruar kompensim të shpejtë dhe të arsyeshëm për viktimat e agresionit.

Masat kufizuese (sanksionet)

41. Pjesëmarrësit njohin vlerën e masave kufizuese (sanksioneve) në kufizimin e aksesit të Federatës Ruse në financat, mallrat, teknologjinë dhe shërbimet që po përdor në agresionin e saj, në tkurrjen e burimeve të të ardhurave të Rusisë dhe për të penguar sulmet e ardhshme.

42. Pjesëmarrësit sjellin në vëmëndje se Bashkimi Europian ka vendosur masa kufizuese (sanksione) të jashtëzakonshme ndaj Federatës Ruse në përgjigje të agresionit kundër Ukrainës dhe që diktojnë sjelljen e pasojave të rënda ndaj Federatës Ruse për veprimet e saj dhe pengimin e forcave ruse për të vazhduar agresionin. Shqipëria i mbështet këto masa (sanksione) kufizuese dhe do të vazhdojë të vendosë sanksione ndaj Rusisë.

43. Pjesëmarrësit do të vazhdojnë të punojnë për të siguruar që kostot ndaj Rusisë për agresionin e saj të vazhdojnë të rriten, duke përfshirë masat kufizuese (sanksionet) dhe kontrollet e eksportit. Shqipëria do të mbetet e përkushtuar, në kuadrin Europian, për të ndjekur masa të forta kufizuese (sanksione) ndaj sektorëve të ekonomisë ruse dhe atyre që mbështesin ose përfitojnë nga lufta, ose ndihmojnë në shmangien e sanksioneve në vendet e treta. Shqipëria gjithashtu do të ndërmarrë veprime drastike me partnerët për të luftuar të gjitha format e anashkalimit të sanksioneve. Shqipëria do të shqyrtojë mundësinë e mbylljes së porteve detare për anijet ruse derisa të rivendoset integriteti territorial i Ukrainës dhe të vendoset paqja e plotë dhe e qëndrueshme.

44. Pjesëmarrësit do t'i japin njëri-tjetrit informacion të përditësuar mbi bazat e masave kufizuese (sanksioneve) dhe informacione të tjera të rëndësishme, në përputhje me detyrimet përkatëse duke marrë parasysh legjislacionin kombëtar.

Mbështetje për axhendën e reformave të Pjesëmarrësve, integrimin europian dhe euroatlantik

45. Pjesëmarrësit ritheksojnë se reforma gjithëpërfshirëse është e domosdoshme për sigurinë e tyre të ardhshme, prosperitetin, demokracitë e tyre dhe qëndrueshmërinë e institucioneve dhe shoqërisë së tyre, si dhe për aspiratat e tyre Europiane dhe euroatlantike.

46. Pjesëmarrësit ritheksojnë se si Shqipëria ashtu edhe Ukraina janë pjesë e familjes Eropiane dhe kanë një të ardhme brenda BE-së. Pjesëmarrësit sjellin në vëmëndje natyrën e bazuar në merita të procesit të anëtarësimit në BE.

Shqipëria dhe Ukraina, në bashkëpunim me BE-në dhe shtetet e saj anëtare, do të vazhdojnë të mbështesin njëra-tjetrën në rrugën e tyre të anëtarësimit.

47. Ukraina angazhohet të vazhdojë të zbatojë reformat e nevojshme me fokus të veçantë në fusha të tilla si drejtësia, zbatimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit, parandalimi i trafikimit të paligjshëm, decentralizimi, administrata publike, mjedisi i biznesit, sektori i sigurisë dhe mbrojtjes që nënvizojnë angazhimet e Ukrainës ndaj demokracisë, shtetit të së drejtës, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive të medias.

48. Shqipëria dhe Ukraina do të mbështesin përpjekjet e njëra-tjetrës për t'u integruar në BE dhe për të miratuar standardet dhe normat e BE-së, duke i ofruar asistencë eksperto-teknike njëra-tjetrës nëpërmjet ministrive, agjencive homologe, administratës dhe fondacioneve të tyre.

49. Pjesëmarrësit ritheksojnë në qëndrimet e tyre se e ardhmja e Ukrainës është në NATO. Shqipëria mbështet përpjekjet e Ukrainës për të zbatuar reformat e nevojshme në rrugën e saj drejt anëtarësimit të ardhshëm në NATO.

50. Pjesëmarrësit ritheksojnë se siguria e Ukrainës është pjesë integrale e sigurisë së rajonit Euroatlantik.

51. Shqipëria do të vazhdojë të mbështesë Ukrainën politikisht dhe praktikisht edhe nëpërmjet Këshillit NATO-Ukrainë, Paketës Gjithëpërfshirëse Shumëvjeçare të Asistencës dhe nëpërmjet Programit Kombëtar Vjetor dhe formateve të tjera. Ukraina angazhohet të vazhdojë të zbatojë reformat e nevojshme në përputhje me Programin e saj Vjetor Kombëtar.

52. Çdo formë e angazhimeve bilaterale të sigurisë ose garancive që i jepet Ukrainës nga partnerët e saj nuk mund të përbëjë alternativë për anëtarësimin e plotë në NATO.

Përfaqësimi i zgjeruar diplomatik

53. Për të nxitur kontakte më të thella dhe më të rregullta midis pjesëmarrësve, administratës, parlamenteve, shoqërive civile, sektorit jo-qeveritar dhe privat, Shqipëria do të rrisë përfaqësimin e saj diplomatik në Ukrainë, për të ofruar njohuri gjithëpërfshirëse mbi nevojat e Ukrainës për mbështetje në kontekstin e Agresionit të Rusisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe.

Pjesa III. Ndihma Humanitare, Bashkëpunimi për Zhvillim dhe Rindërtim

Ndihma Humanitare dhe Bashkëpunimi për Zhvillim

54. Që në fillimet e luftës në shkallë të gjerë, Qeveria e Shqipërisë mori masa për të mbështetur ukrainasit që u detyruan të largoheshin nga lufta. Këto masa përfshinin sigurimin e mbrojtjes së përkohshme për ukrainasit, sigurimin e nevojave arsimore, shërbimet e kujdesit dhe trajtimit shëndetësor, dhe aksesin në tregun e punës. Shqipëria do të vazhdojë të mbështesë qytetarët e Ukrainës deri në fund të luftës. Shqipëria do të vazhdojë të ofrojë ndihmë humanitare për Ukrainën, siç ka bërë që nga dita e parë e pushtimit rus në shkallë të gjerë dhe do të shohë mundësi të tjera për të ofruar mbështetje për Ukrainën, duke filluar nga projektet ekzistuese deri te ngritja e aleancavetë reja, duke përfshirë edhe nxitjen e sektorit privat dhe institucioneve.

55. Për të përmbushur nevojat urgjente të popullsisë ukrainase, Shqipëria do të vazhdojë të ofrojë ndihma humanitare dhe nevoja për mbrojtje civile për popullatën e prekur nga lufta, të ofruara nëpërmjet partnerëve të saj të besuar shqiptarë dhe ndërkombëtarë, së dhe ndihmë të kësaj natyre.

56. Në fushën e bashkëpunimit për zhvillim, Shqipëria do të kërkojë të forcojë mbështetjen që po i bëhet Ukrainës, duke përfshirë fushën e decentralizimit, transportit, energjisë, bujqësisë, ujërave, infrastrukturës më të nevojshme, strehimit dhe sektorëve të shëndetësisë.

57. Duke ditur se shumë anëtarë të forcave të sigurisë dhe mbrojtjes së Ukrainës, së bashku me familjet e tyre, do të vazhdojnë të vuajnë pasojat e dëmtimeve dhe sëmundjeve për shkak të agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, Pjesëmarrësit do të zgjerojnë bashkëpunimin në kujdesin mjekësor duke ndarë ekspertizën, standardet, kornizat dhe praktikat më të mira për mbështetjen e veteranëve të luftës dhe familjeve të tyre. Kjo përfshin mundësinë e kalimit të tyre në jetën civile dhe riintegrimin e suksesshëm në strukturën sociale dhe ekonomike të shoqërisë. Bashkëpunimi do të përfshijë zbatimin e ndërsjelltë të programeve dhe shërbimeve për veteranët dhe familjet e tyre, duke përfshirë rehabilitimin fizik, psikologjik dhe profesional, shërbimet dhe trajtimin e kujdesit shëndetësor, mbështetjen financiare dhe iniciativat përkujtimore për të garantuar mirëqenie gjithëpërfshirëse.

Çminimi Humanitar

58. Pjesëmarrësit pranojnë nevojën për të bashkuar përpjekjet që synojnë mbrojtjen e popullsisë ukrainase nga pasojat shkatërruese të minave. Çminimi

dhe pastrimi i Ukrainës nga mjetet shpërthyese, ndihma për viktimat dhe edukimi për rrezikun nga minat janë baza për rindërtim dhe zhvillim.

59. Duke pasur parasysh shkallën e jashtëzakonshme të sfidës që paraqet ndotja masive e tokës ukrainase nga minat, municionet dhe mjetet e tjera shpërthyese, Shqipëria do të ofrojë mbështetje për veprimet humanitare të çminimit në Ukrainë, përfshirë detin, në bashkëpunim me vendet e tjera partnere. Kjo mbështetje do të përfshijë pastrimin e mjeteve shpërthyese, ndihmën për viktimat, edukimin për rrezikun e minave, shkëmbimin e ekspertizës dhe njohurive, sigurimin e makinerive dhe pajisjeve dhe mbështetjen për kapacitetin institucional të njësive qeveritare të çminimit humanitar.

Rimëkëmbja, Rindërtimi, Zhvillimi i Qëndrueshëm

60. Shqipëria mbështet rimëkëmbjen, rindërtimin dhe modernizimin e Ukrainës në veçanti në fushat e tranzicionit ekologjik, dixhitalizimit, telekomunikacionit, efiçencës së energjisë, asistencës teknike, edukimit dhe shkëmbimit të njohurive, menaxhimit financiar publik dhe rezervave bankare, përpunimit të mbetjeve, trajtimit të ujit, restaurim të mjedisit natyror, ndërtimt, planifikimt dhe infrastrukturën, duke përdorur modele të reja dhe me përkatësi gjinore.

61. Shqipëria dhe Ukraina e dinë se organizmat jo shtetëror do të luajnë një rol themelor në rimëkëmbjen dhe rindërtimin e Ukrainës. Kjo përfshin angazhimin e sektorit privat, shoqërisë civile dhe pushtetit vendor si nxitës të proceseve ambicioze.

62. Me këtë frymë, Shqipëria dhe Ukraina do të promovojnë qasjet biznes-me-biznes dhe shoqërinë civile. Shqipëria do të përdorë instrumentet ekonomike dhe financiare që ka në dispozicion në bashkëpunim me të gjitha organizatat dhe partnerët ndërkombëtarë përkatës.

63. Shqipëria do të punojë së bashku me Ukrainën për të inkurajuar sipërmarrjet, fondacionet dhe institucionet shqiptare që të marrin pjesë aktive në projekte që synojnë rindërtimin e ekonomisë ukrainase, pasi forcimi i sektorit privat është një nga prioritetet e rimëkëmbjes së tij. Pjesëmarrësit do të punojnë së bashku për të forcuar bashkëpunimin midis bashkive të Shqipërisë dhe Ukrainës në nivel të qeverisjes vendore bazuar në marrëveshjet ekzistuese dhe të ardhshme të partneritetit në kuadër të projekteve të rindërtimit. Shqipëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin praktik të projektit të ndërtimit të tremujorit ballkanik.

64. Shqipëria e njeh Kharkivin si një qytet me interes të veçantë në kuadrin e marrëdhënieve të binjakëzimit mes Tiranës dhe Kharkivit dhe do të ketë prioritet mbështetjen e saj për rimëkëmbjen dhe rindërtimin e Ukrainës.

65. Ukraina pranon se procesi i rimëkëmbjes duhet të jetë transparent dhe i përgjegjshëm ndaj popullit të Ukrainës dhe ndaj komunitetit ndërkombëtar.

Fleksibiliteti i Infrastrukturës më të Nevojshme

66. Pjesëmarrësit synojnë të shohin mundësitë për rritjen e fleksibilitetit, restaurimit dhe përmirësimin e mbrojtjes së infrastrukturës më të nevojshme duke dhënë njohuritë dhe praktikat më të mira dhe duke ofruar çdo pajisje të mundshme.

Kultura, arti dhe trashëgimia kulturore

67. Shqipëria, duke pranuar rëndësinë e kulturës dhe artit për shoqëritë demokratike dhe ruajtjen e identitetit dhe traditave ukrainase, do të vazhdojë të bashkëpunojë me Ukrainën për të mbështetur artistët dhe profesionistët e kulturës.

68. Me një angazhim të përbashkët për të mbështetur lirinë e shprehjes si një vlerë themelore Europiane, Shqipëria do të përpiqet të ndihmojë në ringritjen dhe forcimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike në Ukrainë, duke premtuar mbështetje për iniciativat brenda UNESCO-s, Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës që lidhen me ndikimin e agresionit Rus kundër Ukrainës në sektorët e saj kulturorë dhe krijues, duke ecur përkrah Ukrainës në rimëkëmbjen e saj.

Pjesa IV. Bashkëpunimi në rast të një sulmi të armatosur në të ardhmen apo përshkallëzimi serioz

69. Në rast të sulmit të ardhshëm të armatosur rus kundër Ukrainës ose në rast të ndonjë përshkallëzimi serioz të agresionit aktual, me kërkesë të secilit Pjesëmarrës, Pjesëmarrësit do të konsultohen në mënyrë dypalëshe ose nëpërmjet kanaleve të tjera të pranuara nga të dyja palët brenda 24 orëve për të përcaktuar hapat e duhur vijues.

70. Në këto rrethana dhe duke vepruar brenda mundësive dhe aftësive të saj, në përputhje me kërkesat e saj ligjore, kushtetuese dhe sipas rregullave dhe ligjeve ndërkombëtare, Shqipëria do t'i ofrojë Ukrainës, sipas rastit, ndihmë të shpejtë

dhe të qëndrueshme politike, të sigurisë dhe mbrojtjes, ndihmë humanitare dhe ekonomike; do të mbështesë marrëveshjen me partnerët ndërkombëtarë për të imponuar kosto ekonomike dhe të tjera mbi Federatën Ruse dhe të konsultohet me Ukrainën për nevojat e saj, ndërsa ajo do të ushtrojë të drejtën e saj të natyrshme për vetëmbrojtje individuale, të parashikuar në nenin 51 të Kartës së OKB-së.

71. Për të garantuar përgjigjen më të prerë dhe më efektive kolektive ndaj sulmeve të armatosura në të ardhmen, Pjesëmarrësit mund t'i ndryshojnë këto dispozita në mënyrë që t'i harmonizojnë ato me çdo mekanizëm me të cilin ata mund të bien dakord më pas me partnerë të tjerë ndërkombëtarë, duke përfshirë pjesëmarrësit e Deklaratës së G7.

Pjesa V. Dispozitat përfundimtare

72. Bashkëpunimi ndërmjet Pjesëmarrësve në kuadër të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohet në përputhje me ligjet, rregulloret kombëtare dhe detyrimet dhe standardet ndërkombëtare.

73. Nëse është e nevojshme, Pjesëmarrësit do të caktojnë organe të autorizuara për zhvillimin dhe zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe në përputhje me fushat e bashkëpunimit të specifikuara në këtë Marrëveshje.

74. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet dhe plotësohet, duke përfshirë shtimin e anekseve të saj, në çdo kohë nëpërmjet marrëveshjes reciproke me shkrim ndërmjet Pjesëmarrësve.

75. Çdo ndryshim ndërmjet Pjesëmarrësve që rrjedh nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negociatave ose konsultimeve ndërmjet Pjesëmarrësve.

76. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së një njoftimi të dytë me të cilin Pjesëmarrësit do të informojnë njëri-tjetrin, me shkrim nëpërmjet rrugëve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen e saj në fuqi.

77. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë dhjetëvjeçare.

78. Pjesëmarrësit mund të vendosin bashkërisht zgjatjen e kësaj Marrëveshjeje duke u vënë në dijeni jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të periudhës dhjetëvjeçare.

79. Në të njëjtën kohë dhe në përputhje me Deklaratën e G7, Pjesëmarrësit ndajnë mendimin se kjo Marrëveshje thekson në mënyrë objektive që Ukraina të ndjekë një rrugë drejt anëtarësimit në NATO në të ardhmen.

80. Në rast se Ukraina bëhet anëtare e NATO-s përpara skadimit të kësaj Marrëveshjeje, Pjesëmarrësit do të vendosin për statusin e saj të ardhshëm.

81. Kjo Marrëveshje mund të ndërpritet nga secili Pjesëmarrës duke e njoftuar me shkrim Pjesëmarrësin tjetër. Kjo Marrëveshje do të përfundojë 6 (gjashtë) muaj nga data e marrjes së një njoftimi të tillë. Pas përfundimit të kësaj nuk do të ketë ndikime në zbatimin e aktiviteteve ose projekteve në vazhdim, të cilat janë vendosur përpara datës së përfundimit të tij, përveç rasteve kur Pjesëmarrësit vendosin ndryshe.

Nënshkruar në Davos më 21/01/2025 në dy kopje në gjuhën shqipe, ukrainase dhe angleze, në mënyrë autentike autentike. Teksti në anglisht do të jetë primar në rast të ndonjë mospërputhjeje.

Për Republikën e Shqipërisë:	**Për Ukrainën:**
Edi Rama	**Volodymyr Zelensky**
Kryeministri	**Presidenti**